



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

ANEKSI NR. 1 B KUSHTET E VEÇANTA TË SHËRBIMEVE DHE TARIFAVE

Në këtë Aneks, pasqyrohen shërbimet bazë dhe shtesë të ofruara nga ONE dhe të zgjedhura nga Pajtimtari, kushtet e veçanta, tarifave përkatëse të shërbimeve si dhe mënyra e tarifimit.

- Plani Tarifor One HomeNet_Student

	Plani One HomeNet_Student
Pajtimi Mujor	1,020 lekë/muaj
Internet 4G/4G+	510 GB

Ne mënyrë që klienti të përmirësojë shpejtësinë e internetit pasi të ketë konsumuar GB e vlefshme, të përfshira në programin e përcaktuar më sipër, do t'i ofrohet mundësia e blerjes së paketave shtesë të internetit si më poshtë:

Cmimi i paketës	GB e përfshira	Vlefshmëria
300 Lekë	20GB	30 ditë
500 Leke	50GB	30 ditë

Shënime:

- 1) Të gjitha tarifave e mësipërme janë me TVSH të përfshirë.
- 2) GB e përfshira në program janë të vlefshme për një periudhë 1 muaj dhe nuk transferohen në muajt e ardhshëm.
- 3) Njësitë GB të mësipërme nuk janë të vlefshme për t'u përdorur në Roaming.
- 4) Përlllogaritja e konsumit të internetit do të bëhet cdo 100 KB.
- 5) Pas konsumimit të GB të përfshira në paketë, klientët do të vazhdojnë lundrimin në internet por me shpejtësi të kufizuar (256 kbps).
- 6) Paketat shtesë të internetit do të kenë një vlefshmëri prej 30 ditësh.
- 7) Maksimumi i zonave të lejuara për HomeNet është 5 zona. Aktivizimi i 2 zonave të para është falas, 3 zonat shtesë janë me një pagesë prej 300 lekë/zonë.
- 8) Plani HomeNet do të ofrohet me kontratë pajtimi me kohëzgjatje 12 muaj dhe kontratë pajtimi me kohëzgjatje 24 muaj.
- 9) Pagesa fikse mujore dhe GB e përfshira për muajin e parë të aktivizimit do të jetë proporcionale me ditët e mbetura të muajit të aktivizimit të kontratës. Vetëm në faturën e parë të lëshuar do të pasqyrohen detyrimi i muajit paraardhës (proporcional) dhe pagesa fikse mujore e muajit aktual.
- 10) Pagesat fikse mujore në vijim do të aplikohen cdo datë 1 të muajit kalendarik. Në çdo faturë mujore të lëshuar në vijim, do të shfaqet vetëm vlera e pagesës mujore fikse e muajit aktual, paketat shtesë të aktivizuara në muajin e mëparshëm dhe pagesa për aktivizimin e zones shtesë në muajin e mëparshëm.
- 11) Kohëzgjatja minimale e kontratës është 12 muaj. Në rast të zgjidhjes së parakohshme të kontratës prej Pajtimtarit brenda afatit fillestar 12 muaj apo 24 muaj, Pajtimtari ka detyrim të paguajë si penalitet, vlerën e tarifës mujore fikse për të gjithë muajt e mbetur deri në përfundimin e afatit të kontratës 12 muaj ose 24 muaj.
- 12) Në rast kur pajtimtari ka përfituar nga një ofertë promovionale si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertës promovionale, dhe vendos zgjidhje të parakohshme të kontratës, së bashku me detyrimet e përmendura më sipër duhet të paguajë edhe përfitimet nga oferta promovionale (shumën e përfitimeve për të gjithë periudhën promovionale).
- 13) Për të përfituar nga ofertat promovionale të komunikuar nga ONE, pajtimtari duhet të shlyejë detyrimet sipas afatit të përcaktuar në faturë.
- 14) Në rast kur HomeNet ofrohet i kombinuar me plane të tjera tarifore me kontratë, dhe pajtimtari përfiton zbritje në pajtimin mujor apo rritje të benefiteve të HomeNet, përfitimet e HomeNet nuk do të jenë me të vlefshme nëse pajtimtari do të shkëpusë kontratën e planit tarifor të kombinuar me HomeNet.
- 15) Të gjitha pajisjet e dhëna Pajtimtarit nga ONE për ofrimin e shërbimit të internetit, janë pronë e ONE dhe i jepen në përdorim Pajtimtarit për të gjithë kohëzgjatjen e shërbimit. Pajtimtari detyrohet që në rastin e zgjidhjes ose përfundimit të kontratës të pajtimit, t'i kthejë ONE-it këto pajisje.
- 16) Në rast se Pajtimtari zgjidh në mënyrë të parakohshme kontratën e pajtimit për çfarëdo arsyesh dhe nuk i kthen ONE-it pajisjet HomeNet në kuti së bashku me të gjithë aksesoret, ose kur konstatohet prej ONE se pajisjet e dhëna në përdorim



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

- pajtimtarit janë dëmtuar prej tij, atëherë Pajtimtari detyrohet t'i paguajë ONE-it si penalitet vlerën prej 6,000 lekë, krahas detyrimeve të tjera monetare që rrjedhin prej kontratës së pajtimit të lidhur midis palëve.
- 17) Me lidhjen e kontratës së pajtimit, Pajtimtari do të paguajë një shumë prej 1500 lekë, që do të shërbejë si garanci gjatë përdorimit të pajisjes prej tij. Kjo shumë do t'i kthehet Pajtimtarit pasi t'i ketë dorëzuar pajisjen në kuti së bashku me të gjithë aksesorët ONE-it dhe pasi kjo e fundit të ketë kryer verifikimin nëse pajisja funksionon rregullisht nga ana teknike.
 - 18) Në rast se Pajtimtari me zgjidhjen e parakohshme të kontratës ose përfundimin e kontratës së pajtimit sipas afatit të përcaktuar, nuk i kthen ONE-it pajisjet e instaluara HomeNet, në kuti së bashku me të gjithë aksesorët, ose kur konstatohet prej ONE se pajisjet e dhëna në përdorim pajtimtarit janë dëmtuar prej tij, atëherë Pajtimtarit nuk do t'i kthehet shuma prej 1500 lekë që ka paguar si garanci për këto pajisje.
 - 19) ONE Albania ka të drejtë të aplikojë një ndryshim të tarifave të një apo më shumë shërbimeve bazuar në ndryshimin mesatar vjetor të indeksit të cmimeve të konsumit të publikuar nga Instituti i Statistikave (NSTAT), duke ju referuar treguesit të vitit paraardhës. Operatori ka të drejtë të aplikojë këto ndryshime jo më shumë se një herë në vit.
 - 20) Pajtimtari merr përsipër: (i) të përdorë pajisjet vetëm për qëllimin që i janë dhënë në përdorim kundrejt garancisë, nga ONE, duke respektuar të gjitha kushtet e përdorimit të pajisjeve si dhe do të sigurojë që pajisjet të funksionojnë brenda kushteve teknike të kërkuara; (ii) të ruajë pajisjet nga dëmtime të ndryshme që mund t'i ndodhin si pasojë e ndryshimeve në rrymën elektrike, nga dëmtime që mund t'i shkaktohen nga faktorë atmosferikë; (iii) si dhe të ruajë pajisjet nga ndërhyrje të paautorizuara të personave të tretë; në të kundërt Pajtimtari do të konsiderohet përgjegjës për dëmet e mundshme dhe si penalitet, nuk do t'i kthehet shuma prej 1500 lekë që ka paguar si garanci për këto pajisje.